



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 33, 34 dhe 35 të Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe Rregullores Nr 07/2016 për suvencionimin e projekteve filmike të QKK-së shpall:

KONKURS PËR FILM TË METRAZHIT TË GJATË – ARTISTIK (mbi 60 minuta) Ref. Nr. QKK-01/2019

Për Subvencionim të projekteve kinematografike të filmit të gjatë artistik, për vitin 2019. Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë të gjithë personat juridik, vendas ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit dhe paraprakisht të regjistruar në QKK dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë konkurs.

I. Aplikimi bëhet online në linkun www.qkk-rks.com, ku ndër të tjera në aplikim kërkohen:

1. Testi i kulturës;
2. Buxheti;
3. Sinopsisi në gjuhën zyrtare dhe angleze;
4. Skenari në gjuhën zyrtare dhe angleze;
5. Koncepti Regjisorial;
6. CV të autorëve kryesorë;
7. Dy filmat e fundit të regjisorit dhe të producentit (DVD) ose apo forma te tjera, (mund të dërgohen edhe më postë);
8. Dëshmia e pagesës së aplikimit 100.00€ (njëqind euro).

II. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE

1. Shtëpitë filmike dhe producentët që janë me vonesë në zbatimin e kontratës me QKK-në për projektet e fituara më parë, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurimi me më shumë se dy projekte brenda vitit, projektet duhet të jenë të kategorive të ndryshme.

Faqe 1 nga 2

3. Një producent ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
4. Një regjisor ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
5. I njëjti person nuk mund të jetë regjisor dhe producent i të njëjtit projekt.
6. Regjisorit dhe producentit që konkurrojnë me projekt të filmit të metrazhit të gjatë artistik duhet t'i kenë të realizuar së paku nga dy projekte të metrazhit të shkurtër ose një të metrazhit të gjatë.
7. Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në cilesinë e regjisorit.
8. Personat që aplikojnë në cilësinë e regjisorit në një projekt, nuk kanë të drejtë të aplikojnë në cilësinë e producentit në një projekt tjetër dhe anasjelltas.
9. Filmat televiziv të metrazheve dhe zhanreve të ndryshme nuk kanë të drejtë pjesëmarrje/aplikimi.
10. Projektet që janë refuzuar dy herë nuk kanë të drejtë aplikimi.
11. Si dhe kriteret tjera të parapara me rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike të QKK-së.

Vërejtje - referuar Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit: punëtorët e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucioneve vartëse të saj, nuk kanë të drejtë aplikimi në Konkurs.

Data e fundit për aplikim është: **19 MAJ 2019**

Mënyra e pagesës së aplikimit:

Fletëpagesa merret në zyret e QKK-së.